



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"
SENATI AKADEMIK

Nr. 1231 prot.
3

Elbasan, më 17.05.2024

VENDIM

Nr 33 datë 17.05.2024

**"PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË RREGULLOREN E
PROGRAMIT TE STUDIMIT "DOKTORATË NË SHKENCAT MJEKËSORE
TEKNIKE"**

Në mbështetje të Ligjit nr. 80/2015 datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet publike të arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 38, Statutit të UE-së, neni 9, Rregullores së Studimeve në UE-së, me propozim të Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike, Senati Akademik më datë 17.05.2024,

VENDOSI:

- I. Në Rregulloren e programit të studimit "Doktoratë në shkencat mjekësore teknike" bëhen këto shtesa e ndryshime si më poshtë:
 1. Pika 5.4 e nenit 5 ndryshohet dhe bëhet me këtë përmbajtje:

"Dosja e kërkesës për regjistrim në programin e studimeve të doktoratës shqyrtohet nga një Kolegj Doktoral, në përbërjen e të cilit, janë të gjithë anëtarë të njësisë bazë që, mbajnë titullin akademik "Profesor" ose "Profesor i Asociuar". Komisioni përcakton metodologjinë dhe procedurat e vlerësimit të kandidatëve, të cilat bëhen transparente dhe publikohen në faqen e internetit të çdo njësie kryesore, së bashku me afatet e shqyrtimit të dosjeve",
 2. Paragrafi i fundit i nenit 9 ndryshohet dhe bëhet me këtë përmbajtje:

"Në rastet e bashkëudhëheqjes, me personel akademik vendas apo me profesorë të vendeve të huaja, që plotësojnë kriteret e përcaktuara në këtë rregullore, duhet që udhëheqësi/bashkëudhëheqësi të përcaktojë qartë përgjegjësitë e tyre dhe duhet të mbajnë kontakte të rregullta. Udhëheqësi duhet të nënshkruajë një marrëveshje paraprake dhe individuale me bashkëudhëheqësin e huaj për secilin student, në të cilën të jenë përcaktuar qartë klauzolat mbi të drejtat dhe detyrimet e palëve".

3. Pas nenit 13 shtohet neni 13/1 me këtë përmbajtje:

Neni 13/1 Transferimi i studimeve në programin e doktoratës.

1. Kandidatët që ndjekin një program studimi të doktoratës në institucione të arsimit të lartë, vendas ose të huaj, lejohet të transferojnë këto studime, kur fushat e studimit janë të njëjta ose të përafërta me programin e "Doktoratës", të njësisë kryesore.
2. Me qëllim lejimin e transferimit të doktoratës, nga një IAL tjetër vendase ose e huaj në UE, njësia bazë ngre një Komision ad hoc, me tre anëtarë, për të verifikuar nivelin e ngjashmërisë së programeve të doktoratave, fazën dhe nivelin e punimit të doktorantit. Vendimi përfundimtar merret nga drejtuesi i njësisë kryesore, pas propozimit të Komisionit ad hoc, të përcjelle nga drejtuesi i njësisë bazë, i cili jo domosdoshmërisht mund të jete pjesë e komisionit ad hoc, të njësisë bazë.
3. Kur transferimi kërkohet nga një kandidat i një institucioni tjetër të arsimit të lartë, për në UE dhe programi i doktoratës kryhet me vetëfinancim, transferimi kryhet duke mbajtur parasysh e parashikuara në Rregulloren për pranimin në një program studimi të doktoratës.
4. Kur transferimi kërkohet nga një kandidat me program studimi të doktoratës nga UE në një institucion tjetër të arsimit të lartë dhe programi i doktorates kërkohet me vetëfinancim, transferimi kryhet dake mbajtur parasysh kriteret e parashikuara nga kjo Rregullore për pranimin në një program studimi të doktoratës.
5. Kur burimi i financimit është i ndryshëm nga ai i përcaktuar në pikat 3 dhe 4 të këtij neni, transferimi mund të kryhet në varësi të burimit të financimit.
6. Verifikimi i mundësisë së transferimit të programit të studimeve të doktoratës, sipas pikave 3 dhe 4 të këtij neni, bëhet nga një komision ad hoc i ngritur pranë njësisë baze, që ka organizuar kete program studimi. Vendimi përfundimtar merret nga Rektori, pas propozimit të drejtuesit të njësisë kryesore.
7. Në rast financimi nga UE, për kërkimin shkencor mbi projektin e doktoratës përkatëse, kandidati që kërkon transferimin në një tjetër IAL, vendase ose të huaj së bashku me kërkesën e tij për transferim do të kompensojë UE-në për financimin e bërë.
8. Në çdo rast transferimi kandidati duhet të ketë konfirmim zyrtar nga institucioni ku do të transferohet se ky i fundit ka kapacitete të lira për udhëheqjen e kandidatit që kërkon të transferojë studimet.

II. Ngarkohet Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike me zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI**
Prof. Dr. Skender TOPI